



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:288247  
Datë: 21.10.2024  
Numri i dokumentit: 06329031

K.DH.SH.II.nr.955/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Autosalloni 03 Group” Shpk me seli në Pejë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Besim Curri, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.348/22 të datës 27.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.10.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa, e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë e datës 08.04.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.348/22 të datës 27.02.2024, vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.348/22 të datës 27.02.2024, nën pikën I. të dispozitivit, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Autosalloni 03 Group” Shpk me seli në Pejë, nën pikën II. është

anuluar pjesërisht aktvendimi nr.01.3.2.2/20131 i datës 17.11.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe atë lidhur me Deklaratën Unike Doganore me nr. R-955 të datës 25.01.2021 të proceduar në ZBD Prishtina 3. Nën pikën III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë që paditësit “Autosalloni 03 Group” Shpk me seli në Pejë, t’ia kthej shumën prej 847.26€ në emër të tatimit doganor dhe shumën prej 152.50€ në emër të TVSH-së, gjithsejtë 999.76€ (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e gjashtë cent) në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Nën pikën IV. mbetet në fuqi aktvendimi me nr.01.3.2.2/20131 i datës 17.11.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë lidhur me Deklaratat Unike Doganore R-17420/24.09.2020, R-19199/13.10.2020, R-11344/22.07.2020, R-8920/15.06.2020 dhe R-9031/16.06.2020. Ndërsa nën pikën V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovon ankesën në tërësi si të bazuar me ligj, të prish aktgjykimin KF.nr.348/2022 datë 27.02.2024 si të pa bazuar në ligj, të refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj dhe ta lë në fuqi aktvendimin e kontestuar ose t’ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, duke konsideruar se parashtrimi i ankesës ku formulohen fjalitë në atë formë që konsiderohen si të shkelura disa ligje, ceken nene dhe paragraf të gjitha të mbuluara me pretendime të përgjithshme, duke ikur nga gjendja faktike apo duke mos specifikuar faktet konkrete bazuar në të cilat mund të vërtetohen pretendimet konsiderojmë si formë jo të drejtë të përdorimit të mundësive ligjore dhe të drejtave në ankimim që nënkupton se ankesa parashtrohet atëherë kur ka fakte dhe prova konkrete që dëshmojnë pretendimet e ankuesit, andaj ka propozuar që Dhoma e Shkallës së Dytë pas analizimit të fakteve që gjenden në lëndë dhe faktet e lartpërmendura të sjellë aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga e paditura dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal KF.nr.348/2022 i datës 27.02.2024.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore

dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/20131 i datës 17.11.2021, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë “Autosalloni 03 Group” Shpk-Pejë, me numër unik 811368150, për rishqyrtimin e aktvendimit numër 03.1.1-2021-223 të datës 16.09.2021 të Sektori i Kontrollës Pas Importuese, si e pa bazuar. Mbetet në fuqi- aktvendimi numër 03.1.1-2021-223 i datës 16.09.2021 i lëshuar nga Sektori i Kontrollës pas Importuese.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar pjesërisht vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës, në Prishtinë, që paditësit “Autosalloni 03 Group” Shpk me seli në Pejë t’ia kthej shumën prej 847.26€ në emër të tatimit doganor dhe shumën prej 152.50€ në emër të TVSH-së, gjithsejtë 999.76€ në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Me arsyetim se nuk mund te pajtohet me vërtetimin e gjendjes faktike të paditurës dhe qëndrimin juridik të dhënë në arsyetimin e aktvendimit kontestues, për arsye se e paditura fare nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike me të cilën dëshmohet se malli lëndor kontestues nuk i plotëson kriteret për tu pranuar si mall me origjinë preferenciale. Prandaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret e paditura gabimisht ka vendosur kur ka bërë ndryshimin e të dhënave për Deklaratën Unike Doganore R-995 të datës 25.01.2021, në kuptim të preferencës, duke e obliguar subjektin në procedurë që të paguajë detyrime shtesë në vlerë prej 999.76 €, kjo për faktin se subjekti në procedurë ka prezantuar prova të mjaftueshme për të vërtetuar origjinën preferenciale të mallit, respektivisht ka prezantuar EUR1 nr.E.5.863.285 me të cilën vërtetohet origjina preferenciale e mallit. se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për njohjen e origjinës preferenciale për mallin kontestues konform dispozitave ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe e

anuloj pjesërisht aktvendimin e kontestuar të paditurit, duke e obliguar të njëjtin që paditësit t'ia kthej shumën prej 847.26 € në emër të tatimit doganor dhe 152.50 € në emër të TVSH-së, gjithsejtë 999.76 € (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e gjashtë euro), shumë kjo jo kontestuese ngase edhe pala e paditur përmes përfaqësuesit të saj në seancë e ka konfirmuar këtë kur ka deklaruar se : *shuma prej 999.76 euro, është e saktë dhe përputhet me të dhënat nga sistemi Asycuda i Doganës*. Ndërsa sa i përket Deklaratave Unike Doganore R-17420/24.09.2020, R-19199/13.10.2020, R-11344/22.07.2020, R-8920.15.06.2020 dhe R-9031/16.06.2020, gjykata ka vendosur sikurse në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase të njëjtat nuk janë kontestuese, kjo për faktin se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e datës 27.02.2024 ka deklaruar se “*në rastin konkret vetëm një konkret vetëm një Deklaratë Unike Doganore R-955 është kontestuese, ndërsa deklaratat tjera të përcaktuara me aktvendimin bazë 2021-223, e të vërtetuara edhe me aktvendimin kontestues 20131 tanimë nuk janë kontestuese në këtë lëndë*”, andaj edhe gjykata nuk është lëshuar më tej në elaborim dhe vlerësim të të njëjtave.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërin dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa

i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata nuk ka administruar provat për të vërtetuar gjendjen faktike, por vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerr një konkluzion të gabuar duke aprovuar padinë e paditësit pjesërisht, këtë pretendim Dhoma e Shkallës së Dytë, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret Dhoma e Shkallës së Dytë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë bindëse që dëshmon konstatimin se malli lëndor kontestues i paraqitur nga paditësi nuk i plotëson kriteret për tu pranuar si mall me origjinë preferenciale. Në këtë rast e paditura para gjykatës është dashur që me prova bindëse të dëshmoj se paditësi ka vepruar në kundërshtim me ligjin, andaj e paditura nuk ka mundur ta vërtetoj gjendjen faktike vetëm duke u bazuar në informata të reja që ka pas në dispozicion, ku me asnjë fakt të vetëm nuk është vërtetuar se paditësi ka apo nuk ka deklaruar saktë mallin lëndor kontestues sa i përket origjinës së mallit. Kolegji, e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e Dhomës së Shkallës së Parë me të cilën ka vlerësuar se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës se nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës për arsye se ka prezantuar EUR1 nr.E.5.863.285 me të cilën vërtetohet origjina preferenciale e mallit, andaj Dhoma e Shkallës së dytë konstaton se nuk ka prova për çështjen kontestuese dhe pa mbështetjen e provave të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike e paditura nuk ka mundur të nxjerr konkluzion të drejtë në këtë çështje administrative.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji- Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:288247  
Datë: 21.10.2024  
Numri i dokumentit: 06329031

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.955/24, me datë 21.10.2024

Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri